



Accountability, Technology and  
Institutional Openness Network in SEE

# Udhërrëfyes për Qeverisje të Mirë për Institucionet Shtetërore në Kosovë

Bazuar në Indeksin e Hapjes  
Transparencës Rajonale

Për vitin:  
2017



Ky projekt  
financohet nga  
Bashkimi  
Evropian



Projekti "Llogaridhënia, Teknologjia dhe Transparenca Institucionale në Evropën Juglindore - ACTION SEE" implementohet nga Fondacioni Metamorphosis, Fondacioni Westminster për Demokraci, CRTA - Qendra për Kërkim, Transparenca dhe Përgjegjësia, Shoqata e Qytetarëve Pse jo?, Qendra për Tranzicion Demokratik, Open Data Kosovo (ODK) dhe Lëvizja Mjaft!





Udhërrëfyes për  
Qeverisje të Mirë  
për Institucionet  
Shtetërore në Kosovë

Për vitin: 2017

Prishtinë, Dhjetor 2018

## PUBLIKUESI:



Open Data Kosovo

Open Data Kosovo promovon idenë që të dhënat qeveritare duhet të jenë të hapura, dhe lirisht të disponueshme për të gjithë që t'i përdorin dhe ripublikojnë sipas dëshirës, pa kufizime nga autorit, patentt ose mekanizmat e tjerë të kontrollit.

Adresa: "Ganimete Tërbeshi" 26A,  
10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 49 666 412

Web: [opendatakosovo.org](http://opendatakosovo.org)

E-mail: [info@opendatakosovo.org](mailto:info@opendatakosovo.org)

### Publikuesi:

Blerina Ramaj

### Redaktorët:

Blerta Thaçi

Dafina Olluri

### Hulumtuesja:

Diellza Olluri



ACTION SEE (Accountability, Technology and Institutional Openness Network in the South East Europe region) është një rrjet i organizatave të shoqërisë civile që punojnë së bashku në promovimin e llogaridhënjes në regionin e Evropës Jug-Lindore, duke ngritur potencialin për aktivizëm qytetar, promovimin e të drejtave të njeriut dhe liritë në internet, dhe duke ndërtuar kapacitetet dhe interesimin brenda shoqërisë civile për të përdorur teknologjinë për promovimin e demokracisë. Antarët themelor të organizatës janë Metamorphosis nga Maqedonia, Center for Democratic Transition nga Mali i Zi, Center for Research, Transparency and Accountability nga Serbia, dhe Why Not nga Bosnja dhe Hercegovina. ACTIONSEE punon me partnerët nga Shqipëria të organizatës MJAFT! dhe Open Data Kosovo nga Kosova.

## KORDINATORI I PROJEKTIT:

Metamorphosis Foundation

Maqedoni

[www.metamorphosis.org.mk](http://www.metamorphosis.org.mk)

## ORGANIZATAT PARTNERE:

Westminster Foundation for Democracy

Britani e Madhe

[www.wfd.org](http://www.wfd.org)

CRTA - Center for Research,  
Transparency and Accountability

Serbi

[www.crt.rs](http://www.crt.rs)

Citizens Association Why not?

Bosna dhe Hercegovina

[www.zastone.ba](http://www.zastone.ba)

Center for Democratic Transition

Mali i Zi

[www.cdtmn.org](http://www.cdtmn.org)

Open Data Kosovo (ODK)

Kosovë

[www.opendatakosovo.org](http://www.opendatakosovo.org)

Levizja Mjaft!

Shqipëri

[www.mjaft.org](http://www.mjaft.org)

# PËRMBAJTJA

<b>1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME</b>	<b>5</b>
<b>2. INSTITUCIONET SHETRORE</b>	<b>7</b>
<b>2.1 EKZEKUTIVI QENDROR – ZYRA E KRYEMINISTRIT</b>	<b>7</b>
<b>2.1.1 REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME</b>	<b>7</b>
QASJA NË INFORMATA	7
Monitorimi, Raportimi, Planifikimi Strategjik	8
Integriteti & Transparenca	9
<b>2.1.2 HAPAT E VEPRIMIT</b>	<b>10</b>
<b>2.2 KUVENDI</b>	<b>12</b>
2.2.1 REKOMANDIMET	12
2.2.2 HAPAT E VEPRIMIT	16
<b>2.3 GJYQËSORI</b>	<b>18</b>
2.3.1 REKOMANDIMET	18
2.3.2 HAPAT E VEPRIMIT	21
<b>2.3.3 GJYKATA</b>	<b>22</b>
2.3.3 HAPAT E VEPRIMIT të Gjykatave	22
<b>2.4 PROKURORIA</b>	<b>23</b>
2.4.1 REKOMANDIMET	23
2.4.2 HAPAT E VEPRIMIT	25
<b>2.5 ZYRA E KRYEPROKURORIT</b>	<b>26</b>
2.5.1 REKOMANDIMET	26
2.5.2 HAPAT E VEPRIMIT	28
<b>2.6 KOMUNAT</b>	<b>29</b>
2.5.1 REKOMANDIMET	29
2.5.2 HAPAT E VEPRIMIT	30
<b>3. METODOLOGJIA</b>	<b>32</b>
<b>4. PROJEKTI</b>	<b>34</b>



# 1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Transparenca/hapja përfaqëson një kusht kyç të demokracisë – pasi që ajo u mundëson qytetarëve të marrin informacion dhe njohuri të nevojshme për një pjesëmarrje të barabartë në jetën politike dhe për një vendim-marrje efektive dhe mbajtjen e institucioneve të përgjegjshme për politikën që ato udhëheqin. Institucionet e ndryshme rreth botës ndërmarrin aktivitete specifike me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve.

Qeverisja e hapur apo transparente bazohet në katër parime organizative: transparencë, qasshmëri, integritet dhe ndërgjegjësim. Këto parime duhet të zbatohen për të gjitha degët dhe nivelet e qeverisjes, nga ekzekutivi qendror deri tek vetëqeverisja lokale, në parlament dhe sistemin gjyqësor.

Indeksi i Transparencës/Hapjes është një tregues i përbërë që mat shkallën në të cilën qeveritë e shteteve të Ballkanit Perëndimor janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë dhe është i projektuar në atë mënyrë që të përcaktohet se në çfarë shkalle qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin informacion të përshtatshëm dhe të kuptueshëm nga institucionet e tyre.

Indeksi i Hapjes/Transparencës është pjesë e ACTION SEE – Projekti “Llogaridhënia, Teknologjia dhe Transparenca Institucionale në Evropën Juglindore”, projekt ky i financuar nga Bashkimi Evropian, i cili implementohet nga 7 organizata në 6 shtete: Fondacioni Metamorphosis në Maqedoni, CRTA - Qendra për Hulumtim, Transparencë dhe Përgjegjësi në Serbi, Shoqata Qytetare Pse jo? në Bosnje dhe Hercegovinë, Qendra për Tranzicion Demokratik (CDT) në Mal të Zi, Open Data Kosovo (ODK) në Kosovë dhe Lëvizja Mjaft! në Shqipëri, dhe Fondacioni për Demokraci Westminster.

Për më tepër, ActionSEE është një rrjet i organizatave të shoqërisë civile që punojnë bashkërisht në promovimin dhe sigurimin e llogaridhënies dhe transparencës së qeverisë në rajonin e Evropës Juglindore, duke rritur potencialin për aktivizim qytetar dhe pjesëmarrjen qytetare, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në internet dhe ndërtimin e kapaciteteve dhe interesave brenda organizatave të shoqërisë civile dhe individëve në rajon duke përdorur teknologjinë në punën e promovimit të demokracisë.



Për këtë qëllim, për të matur shkallën e hapjes institucionale, partnerët e ACTION SEE duke vepruar sipas standardeve ndërkombëtare, rekomandimeve si dhe shembujve të praktikave të mira, vlerësuan institucionet përmes treguesve të veçantë sasiorë dhe cilësorë, të cilët vlerësojnë institucionet në bazë të: qasshmërisë së informacionit në ueb faqet zyrtare të institucioneve, cilësinë e kornizës ligjore, burimet e tjera të informimit publik dhe pyetësorë të dorëzuar në institucione.

Përgjigjja e institucioneve ndaj pyetësorëve ishte një tregues shtesë për transparencën/hapjen e tyre. Shumë institucione morën pikë negative prej treguesve për shkak të mos përgjigjes së tyre, gjë që është gjithashtu e rëndësishme për t'u përmendur për dy arsye: së pari, përgjigjja apo reagimi institucional është një tregues për vetë hapjen/transparencën dhe së dyti mos përgjigjja e institucionit ka ndikuar negativisht në rezultatet e indeksit të tyre, sepse ata automatikisht u notuan me 0. Përveç kësaj, disa nga treguesit mund të jenë vlerësuar pozitivisht nëse janë zbatuar vetëm ligjet ekzistuese.

Matja u zhvillua në periudhën nga tetori deri në fund të dhjetorit 2016. Bazuar në të dhënat dhe gjetjet e monitorimit, u zhvilluan një grup rekomandimesh dhe udhëzuesish drejtuar institucioneve në bazë të rezultateve të hulumtimit. Hapat e rekomanduar për secilën kategori të institucioneve janë bërë në bazë të treguesve që nuk janë përbushur plotësisht. Përveç kësaj, meqë disa nga kategoritë e institucioneve janë marrë si mostra, si agjencitë ekzekutive, vetëqeverisjet lokale, gjykatat dhe prokuroritë, për këto institucione rekomandimet dhe hapat e veprimit janë të përgjithshme për të gjithë grupin e institucioneve.

Lexuesit mund të gjejnë metodologjinë dhe informacionin e përgjithshëm të projektit në fund të këtij dokumenti.



## 2. INSTITUCIONET SHETËRORE

### 2.1 PUSHTETI EKZEKUTIV – ZYRA E KRYEMINISTRIT

#### 2.1.1 REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME

Kosova vjen në vendin e tretë në hapjen e pushtetit ekzekutiv me një rezultat të përgjithshëm prej 31% të indikatorëve të arritur.

#### QASJA NË INFORMATA

Edhe pse egziston Infrastruktura për qasje në informata është e pranishme dhe ligji për qasje të lirë në dokumentet publike që rregullon mënyrën e funksionimit të Lirisë së Informacionit ekziston. Institucioni ka një person të caktuar i cili merret me kërkesat për qasje në dokumentet publike dhe ekziston një afat i arsyeshëm kohor për t'iu përgjigjur kërkesave. Sidoqoftë, e drejta për qasje në informata nuk duket se zbatohet për ndërmarrjet shtetërore, kompanitë publike apo entitetet e tjera që janë në pronësi apo të kontrolluara nga shteti. Institucionet deri më tani nuk kanë ofruar një listë apo regjistër të dokumenteve që janë në dispozicion dhe në posedim të tyre dhe nuk i bëjnë ato publike, edhe pse kjo që parashihet me ligj

Zyrës së Kryeministrit, gjithashtu i mungon një bashkëveprim më aktiv me qytetarët, në cilën fushë Kosova u vlerësua me më pak pikë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Një hap i parë drejt përmirësimit të këtij aspekti të hapjes do të ishte kalimi në mënyra më bashkëkohore të ndërveprimit me qytetarët, si Twitter dhe Facebook.



## Monitorimi, Raportimi, Planifikimi Strategjik

Kosova mori rezultatin e dytë më të ulët në ndërgjegjësim, duke shënuar vetëm 25%, dhe duke lënë prapa vetëm Serbinë, e cila mori një rezultat prej 18%. Vërehet një përmirësim i vogël nga matja e fundit, ku Kosova u rendit e fundit në rajon, duke shënuar 24%. Një nga elementet kryesore që mungon në Zyrën e Kryeministrit është vlerësimi dhe monitorimi i përgjithshëm i projekteve dhe politikave, në të cilat Kosova ka shënuar 0% në bazë të indikatorëve. Kështu, Kosova u rendit i fundit në rajon. Një pasqyrë kontekstuale tregon se Kosova është ekspozuar ndaj shumë projekteve dhe politikave të orientuara nga donatorët. Megjithatë, nuk ekziston një mekanizëm për monitorimin e performancës së këtyre projekteve dhe politikave dhe ndikimin e programeve dhe planeve të reformës. Progresi ose regresi nuk dokumentohen, gjë që përbën një sfidë të madhe ndaj hapjes, si dhe një rrezik joefikasiteti. Komponenti i vetëm në fushën e Ndërgjegjësimit në të cilën Kosova ka marrë një rezultat prej 100% është komponenti i raportimit të Ministrisë, ku Kosova e ndan këtë rezultat me Maqedoninë.

## Integriteti

Kjo është një fushë në të cilën Zyra e Kryeministrit është duke punuar mirë, me një rezultat prej 82% në bazë të indikatorëve, Kosova u rendit e dyta menjëherë pas Malit të Zi. Kjo lidhet kryesisht me deklarimin e pasurisë nëpërmjet kartave të aseteve, të cilat menaxhohen nga Agjencia Kundër Korrupsionit, ku në studimin tonë bien nën kategorinë e Integritetit. Indikatorët e integritetit lidhen me deklarimin e pasurisë, kodin e sjelljes dhe konfliktin e interesit, ku në të tria, proceset janë të rregulluara dhe i japin këtij institucioni një rezultat më të lartë.

## Transparenca

Transparenca matet në mes të tre komponentëve: informacioni organizativ, prokurimi publik dhe transparenca buxhetore. Kosova ka shënuar vetëm 29% në bazë të këtyre indikatorëve, duke u renditur e fundit në rajon. Një nga mangësitë më të mëdha të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës është transparenca buxhetore. Faqja zyrtare nuk përmban shpenzimet buxhetore dhe llogaritë përfundimtare. Nuk ka informacion për nivelin dhe përbërjen e borxhit (nëse ekziston) dhe mënyrën se si menaxhohet borxhi.

Web-faqja e Ministrisë së Financave përmban buxhetin e përgjithshëm që mbulon shpenzimet e përgjithshme të institucioneve të Kosovës, mirëpo faqja e internetit e zyrës së Kryeministrit nuk siguron informacion të qasshëm, të kuptueshëm dhe gjithëpërfshirës mbi buxhetin e planifikuar dhe shpenzimet qeveritare.

Sa i përket transparencës në informacionin organizativ, Zyra e Kryeministrit të Kosovës<sup>9</sup> ka shënuar 36% në bazë të indikatorëve të caktuar duke u renditur e fundit në rajon edhe një herë, gjë që tregon një rënie krahasuar me matjet e vitit të kaluar në të cilën Kosova shënoi 63%. Në përgjithësi, faqja e internetit është e pasur me njoftime për shtyp të seancave të Qeverisë, dokumente zyrtare, raporte, strategji, plane vjetore të punës dhe deri në një masë me informacione mbi shërbyesit civilë. Megjithatë, ekziston një problem me konsistencën dhe organizimin e dokumenteve të tilla brenda faqes së internetit. Jo gjithmonë informacioni është i paraqitur në dy gjuhët zyrtare të vendit, i cili është një kusht brenda Kushtetutës, raportet janë të shpërndara dhe nuk ndjekin ndonjë strukturë specifike.

Problemi kryesor në të gjithë rajonin është kur flitet për transparencën është prokurimi publik. Kosova renditet e fundit në rajon dhe vendoset prapa Malit të Zi, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Maqedonisë, me një rezultat prej vetëm 32% bazuar në indikatorët e caktuar. Ndërkohë që në matjen e fundit në 2016, Kosova shënoi 40%. Faqja e internetit e Zyrës së Kryeministrit nuk i posedon planet dhe rezultatet e prokurimit. Një mënyrë efektive për përmirësimin e rezultatit të transparencës do të ishte publikimi i rregulloreve, planeve dhe rezultateve të prokurimit në faqen e internetit në mënyrë që të jenë të qasshe për qytetarët.

## 2.1.2 HAPAT E VEPRIMIT

Për të rritur rezultatin e përgjithshëm, tek Pushteti Ekzekutiv të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- Të krijohen dhe përditësohen listat e regjistrave të dokumenteve që ata kanë në posedim dhe të vihen ato në dispozicion të publikut;
- Të sigurohet që qeveria të ketë një llogari aktive të Facebook-ut dhe Twitter-it për komunikim me publikun;
- Të hartohet plan ose strategji për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve të nëpunësve civil për përdorimin e mediave sociale si pjesë e detyrave të tyre zyrtare;
- Të zgjerohet e drejta për qasje në dokumente publike edhe për ndermarje publike në ndërmarrjet shtetërore duke bërë ndryshimin e legjislacionit ose rregulloreve përkatëse
- Të rregullohen lobistët dhe aktivitetet e lobimit duke miratuar një ligj për këtë fushë
- Të institucionalizohet ekzistimi i detyrueshëm të një regjistri të lobistëve dhe të vendoset një organ të pavarur përgjegjës për menaxhimin e këtij regjistri
- Të themelohet një mekanizëm përmes të cilit qytetarët do të jenë në gjendje të sfidojnë vendimet të cilat janë marrë përmes një procesi jo adekuat Monitorimi, Raportimi, Planifikimi Strategjik
- Të krijohet një kornizë ligjore dhe një sërë treguesish për monitorimin e performancës dhe efektivitetin e politikave, si dhe ndikimin e programeve dhe planeve reformuese (gjatë zbatimit dhe pas); të hartohet një dokument i brendshëm që rregullon dhe udhëzon monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe projekteve;
- Të vendoset një procedurë për raportimin e arritjeve dhe mangësive të politikave në ZKM individualisht nga ministrinë përkatëse;
- Të forcohen mekanizmat ekzistues për vlerësimin e ndikimeve të mundshme të akteve ligjore ekzistuese ose të përgatitura (duke përfshirë vlerësimet rregullative)
- Të krijohet një organ brenda Zyrës së Kryeministrit i ngarkuar me planifikimin strategjik të politikave qeveritare.
- Të vendosen mekanizma të qarta për zbatimin e Kodit të Etikës;
- Të zhvillohen dhe përcaktohen më tej procedurat brenda Kodit të Etikës për trajtimin e shkeljeve të Kodit.

- Të sigurohet që informatat e kuptueshme dhe gjithëpërfshirëse për buxhetet dhe llogaritë përfundimtare mbi shpenzimet buxhetore të publikohen në ueb faqen e të ZKM-së (duke përfshirë tabelat dhe sqarimet verbale), të publikohet një raport gjashtë mujor për shpenzimet buxhetore;
- Të sigurohet që projektligji për buxhetin dhe dokumentacioni mbështetës i buxhetit të përfshijnë kostot që janë të diferencuara nga njësitë shpenzuese duke përfshirë klasifikimin funksional dhe atë ekonomik;
- Të institucionalizohet praktika e publikimit të raporteve brenda Vitit mbi borxhin aktual;
- Të zhvillohet një bazë ligjore për një proces transparent të buxhetimit duke përfshirë pjesëmarrjen e publikut në përgatitjet e buxhetit të shtetit;
- Të krijohet dhe Publikohet Buxheti i Qytetarëve. Informata mbi Organizatën
- Të publikohet në ueb faqe programi vjetor i punës, i informatave lidhur me personelin (duke përfshirë emrat dhe pozitat), pagat, kontaktet, fushëveprimin institucional, organogramin, rezymetë e stafit dhe raportet e punës, si dhe listën e regjistrave të dokumenteve në posedim të saj;
- Të sigurohet publikimi i njoftimeve për shtyp mbi seancat e qeverisë dhe informatat rreth konferencave për shtyp pas takimeve të kabinetit qeveritar në ueb faqen e ZKM-së;
- Të publikohen agjendat e seancave të ardhshme qeveritare dhe procesverbalet e seancave të kaluara në ueb faqen e qeverisë.
- Të sigurohet që informatat kontraktuese të jenë në dispozicion të publikut në ueb faqen e ZKM-së; Të sigurohet që planet, thirrjet, vendimet, kontratat dhe anekset lidhur me prokurimin publik janë të publikuara në ueb faqe;
- Të kompletohen rregullat ekzistuese dhe procedurat në mënyrë që t'u mundësohet ofertuesve të pasuksesshëm që të iniciojnë një rishikim zyrtar të vendimeve të prokurimit;
- Të definoen kushtet specifike për ofertat njëburimore (situata në të cilën një furnitor është burimi i vetëm i një aftësie, produkti, shërbimi, apo teknologjie)

## 2.2 KUVENDI

### 2.2.1 REKOMANDIMET

#### Qasshmëria

Parlamenti i Kosovës ka shënuar 45% të indikatorëve në aspektin e Qasshmërisë. Ky rezultat e vendos Parlamentin e Kosovës në fund të listës krahasuar me vendet e tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor, duke lënë prapa vetëm Bosnjën dhe Hercegovinën. Në indeksin e vlerësimeve, Kosova u vlerësua si e pajisur me infrastrukturë të mirë për lirinë e informimit, i cili është faktori më i rëndësishëm i përfshirë në Ligjin për Qasjen në Dokumente Publike. Institucioni ka një person të caktuar që merret me kërkesat e QDP-së dhe ka një afat kohor minimal të arsyeshëm për t'iu përgjigjur kërkesave. Sidoqoftë, e drejta për qasje në informata ende nuk duket se zbatohet për ndërmarrjet shtetërore, kompanitë publike apo entitete të tjera që janë në pronësi apo të kontrolluara nga parlamenti, gjë që konsiderohet si problem i vazhdueshëm nga matja e fundit. Një aspekt tjetër që pengon zbatimin e duhur të këtij ligji është dështimi për të publikuar një listë të regjistrave dhe dokumenteve të saj, siç kërkohet me ligj.

Kjo është e ngjashme me situatën në institucionet ekzekutive dhe institucionet e tjera publike. Vendosja e një praktike të tillë do të thjeshtonte procedurën si për zyrtarin publik ashtu edhe për parashtruesin e kërkesës. Një mangësi e ngjashme zakonisht gjendet në të gjitha vendet e rajonit, por është relativisht e thjeshtë që një gjë e tillë të korrigjohet dhe kjo menjëherë do të rriste rezultatin e hapjes/ transparencës së institucionit. Një mangësi tjetër në këtë drejtim është se nuk ka organ të pavarur mbikqyrës ose komision informimi, të cilët do të siguronin që Ligji për qasje në dokumente publike të zbatohet brenda Parlamentit dhe të gjitha kërkesat të trajtohen në kohë dhe në përputhje me rrethanat.

Propozohet që Parlamenti i Kosovës të ketë edhe një rrjet të drejtpërdrejtë të komunikimit në faqen e tyre të internetit e cila do të jetë në dispozicionin e qytetarëve për të paraqitur shqetësime, ankesa dhe për të bërë apele për punën e parlamentit. Kjo shtesë e vogël do të ndihmojë në rritjen e nivelit të hapjes.

## Efektiviteti

Nëse flasim për ndërgjegjësimin, i cili ka të bëjë me planifikimin strategjik dhe monitorimin e Parlamentit, Kosova ka shënuar 16% në aspektin e nivelit të hapjes. Ky është rezultati më i ulët në rajon, ndërkohë që të gjitha parlamentet e tjera në rajon kanë shënuar mbi 50% të këtij indikatori. Parlamenti i Kosovës nuk arrin të vlerësojë ndërgjegjësimin dhe ndikimin e ligjeve të saj, pavarësisht nëse ato janë duke hyrë ose tashmë janë në fuqi. Gjithashtu Parlamenti nuk ka miratuar asnjë dokument për strategji, politika apo procedura që merren me këtë çështje, gjë që do të rriste nivelin e hapjes dhe transparencës. Vlerësimi i ndikimit është i rëndësishëm, pasi që ai i mundëson Parlamentit të vë në dukje raste të politikave dhe ligjeve joefektive. Duhet të parashikohen mënyra se si të matet ndikimi i ligjeve dhe pastaj të përdoren sistematikisht.

## Integriteti

Në komponentin e integritetit, Kosova shënoi 69%; kjo përqindje tregon rënie nga 83%, i cili ishte rezultati që e ka marrë Kosova në matjen e fundit. Megjithatë, mbetet një vend prapa Malit të Zi, i cili mori një rezultat prej 97%. Indikatorët e kodeve të etikës së masave të integritetit, parandalimi i konfliktit të interesit, rregullat e lobimit- të cilat nuk zbatohen në Kosovë dhe deklarimi i pasurisë së deputetëve të parlamentit. Të gjitha këto aspekte janë të rregulluara me Ligjin për të Drejtat dhe Privilegjet e Anëtarëve të Parlamentit dhe Ligjin mbi Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pronës së Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Dhuratave të të gjithë Zyrtarëve Publikë. Këto dy ligje sigurojnë një bazë të mirë për zhvillimin e integritetit parlamentar, mirëpo nuk ka zhvillim të rregullimit të kodit të etikës të deputetëve brenda parlamentit, përkundër kapitullit në Ligjin për të Drejtat dhe Privilegjet e deputetëve. Për shkak të mos-miratimit të kësaj rregulle, tre indikatorët e tjerë të bazuar në mekanizmin e monitorimit të këtij kodi, procedurat që merren me shkeljen dhe një version i tij në internet, marrin rezultatin zero.

## Transparenca


Vlerësimi i nivelit të transparencës së Kuvendit të Kosovës u realizua me matjen e indikatorëve që kanë të bëjnë me informacionat mbi nivelin organizativ, prokurimin publik dhe buxhetin. Në këtë kategori, Kosova shënoi 48%, që tregon një rënie nga rezultati 60% që mori hera e fundit. Prandaj, nga renditja në vendin e dytë në matjen e fundit, këtë vit Kosova u rendit e fundit në rajon. Vendi që u rendit i pari në aspektin e Transparencës është Mali i Zi, duke shënuar 78% në bazë të indikatorëve.

Në përgjithësi, Parlamenti i Kosovës mori një rezultat të mirë lidhur me informacionin organizativ - një komponent që shqyrton cilësinë dhe sasinë e informacionit mbi funksionimin e këtij institucioni. Faqja zyrtare e Parlamentit është e pasur me të gjitha ligjet, ndryshimet ligjore, projektligjet, rregulloret, strategjitë dhe raportet e punës. Një veçori tjetër, e cila kontribuon në transparencën e Parlamentit, është platforma online “Legislative Tracking System” që u mundëson qytetarëve të shohin se në cilën fazë të miratimit është secili ligj. Seancat parlamentare transmetohen rregullisht, agjendat publikohen paraprakisht dhe faqja e internetit vazhdimisht përditësohet.

Seancat parlamentare transmetohen rregullisht, agjendat publikohen paraprakisht dhe ueb faqja përditësohet vazhdimisht. Ajo çka mungon është evidenca e pjesëmarrjes së deputetëve në seancat parlamentare, si dhe më shumë informata rreth zyrtarëve publik që punojnë në këtë institucion. Qëllimi i tërë kësaj duhet të jetë publikimi i informatave rreth departamenteve të ndryshme, zyrtarëve publikë që punojnë atje, duke përfshirë rezymetë e tyre dhe informatat e pagave, me qëllim që të arrihet transparenca e plotë organizative.







## 2.2.2 HAPAT E VEPRIMIT

Me qëllim të rritjes së rezultatit të përgjithshëm dhe adresimit të çështjeve të cekura më lart, Kuvendi i Kosovës duhet të ndërmarrë hapat në vijim:

- Të krijohen mekanizma për pranimin e komenteve publike mbi projektligjet;
- Të krijohet një praktikë e rregullt e kërkimit të komenteve publike mbi ligjet/strategjitë/ deklaratat/aktet dhe dokumente të tjera;
- Të sigurohet që Kuvendi të ketë një llogari aktive të Facebook-ut dhe Twitter-it për komunikim me publikun;
- Të krijohet një mekanizëm për peticionet elektronike dhe të krijohet një politikë/plan komunikimi për promovimin e tyre;
- Të fillohet promovimi në mënyrë aktive i mekanizmit të peticionit elektronik në ueb faqen e saj ose në mediat sociale;
- Të zgjerohet e drejta e qasjes në dokumente publike në ndërmarrjet shtetërore duke bërë ndryshim-plotësimet e kërkuara në legjislacionin ose rregulloret përkatëse;
- Të obligohen autoritetet publike për të krijuar dhe azhurnuar listat e regjistrave të dokumenteve në posedim të tyre dhe për t'i bërë ato publike;
- Të krijohet një sistem i trajnimit dhe udhëzimit për t'i mundësuar punonjësve të gjykatave që të vlerësojnë të dhënat, bazat e të dhënave dhe informatave të tjera që duhet zbuluar;
- Të përmirësohen më tej informatat e disponueshme lidhur me qasjen/hyrjen në ndërtesën e Kuvendit (p.sh. qendra e vizitorëve, vizitat me udhëheqës, vizitat arsimore, orët e pritjes, qasja/prezenca në seancat plenare etj.)
- Të krijohet një procedurë parlamentare për sjelljen e përfaqësuesve të kabinetit qeveritar në Kuvend për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve.
- Të forcohen mekanizmat ekzistues për vlerësimin e ndikimeve të mundshme të akteve ligjore ekzistuese ose të përgatitura (duke përfshirë vlerësimet rregullative)
- Të rregullohen lobistët dhe aktivitetet e lobimit duke miratuar një ligj për këtë fushë;
- Të institucionalizohet një ekzistim i detyrueshëm i një regjistri të lobistëve dhe të vendoset një organ i pavarur përgjegjës për menaxhimin e këtij regjistri;
- Të forcohen mekanizmat ekzistues për monitorimin e zbatimit të Kodit të Etikës për deputetët; Të hartohen procedura kundër bërjes publike të informatave mbi rezultatet përfundimtare të hetimeve në akuza për sjellje joetike;
- Të institucionalizohet një natyrë obliguese/detyruese (nëpërmjet ligjit ose rregullores) të vendimeve të një organi të pavarur mbikëqyrës;
- Të krijohet një organ i pavarur mbikëqyrës ose komision për informim për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e së drejtës për informacion;

- Të kompletohet dokumentacioni ekzistues i mbikëqyrjes për periudhën e kaluar (sidomos për dy vitet e fundit);
- Të forcohet llogaridhënia e zyrës së auditimit ndaj Kuvendit.
- Të publikohet dokumentacioni dhe regjistrimet e votimit për seancat e komisioneve;
- Të publikohen në ueb faqe transkriptat dhe regjistrimet e votimit të plenumit;
- Të publikohen në ueb faqe organogrami institucional, fushëveprimi i punës, rezymetë, emrat e personelit, pozitat, pagat, kontaktet, lista e regjistrave të dokumenteve në posedim të Kuvendit, plani vjetor të punës;
- Të përmirësohen audio dhe video transmetimet e grupeve punuese;
- Të përmirësohen audio dhe video transmetimet të seancave plenare;
- Të sigurohen informatat e rregullta për pjesëmarrjen e deputetëve në komisione dhe seanca plenare;
- Të vendoset pjesëmarrja, transparenca dhe vlerësimi i cilësisë brenda procesit të VNR-së
- Të vendosen politikat dhe procedurat që qeverisin publikimet dhe marrëdhëniet e Kuvendit; Të bëhen ndryshim-plotësimet e kërkuara në ligj për të institucionalizuar ndalimin e pjesëmarrjes së kompanive të dënuara për rryshfet në ofertat e ardhshme të prokurimit;
- Të sigurohet që planet, thirrjet, vendimet, kontratat dhe anekset lidhur me prokurimin publik janë të publikuara në ueb faqen e Kuvendit;
- Të kompletohen rregullat dhe procedurat ekzistuese në mënyrë që t'u mundësohet ofertuesve të pasuksesshëm të iniciojnë një rishikim zyrtar të vendimeve të prokurimit;
- Të kompletohet korniza ekzistuese ligjore në mënyrë që të sigurohet një tenderim konkurrues në prokurimet e mëdha (> 0.5% e GDP-së);
- Të definohen kushtet specifike për ofertat njëburimore (situata në të cilën një furnitor është burimi i vetëm i një aftësie apo teknologjie);
- Të sigurohet që propozimi i buxhetit të qeverisë të diskutohet në një numër të mjaftueshëm të seancave të komisioneve;
- Të sigurohet që projektligji për buxhetin dhe dokumentacioni mbështetës i buxhetit përfshijnë kostot që janë të diferencuara nga njësitë shpenzuese duke përfshirë klasifikimin funksional dhe atë ekonomik;
- Të sigurohet që buxheti dhe llogaritë përfundimtare mbi shpenzimet buxhetore publikohen në ueb faqen e Kuvendit, publikimi i raportit gjashtë mujor për shpenzimet buxhetore;
- Të krijohet një praktikë nga ana e Zyrës së Shtetërore të Auditimit që të kryej në kontroll të llogarive përfundimtare;
- Të publikohet Buxheti i Qytetarëve.

## 2.3 GJYQËSORI

### 2.3.1 REKOMANDIMET

#### Këshilli Gjyqësor dhe Gjykatat

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka nevojë për përmirësim në shumë fusha. Nga një perspektivë rajonale, KGJK e gjen veten në pjesën më të fundit të spektrit njëjtë si në matjen e fundit, i tejkalar nga Mali i Zi, lider mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, për më shumë se tridhjetë pikë të përqindjes (79%). Me vetëm 41% të treguesve të përcaktuar krahasuar me matjen e fundit ku kishte shënuar 43% të kriterëve të përmbushura të hulumtuara, vetëm Shqipëria ka shënuar më pak prej 1% të treguesve të përcaktuar të gjykatave por duhet të kemi parasysh se Shqipëria i ka në vazhdimësi reformat e sistemit gjyqësor. Pra, rezultatet e Shqipërisë nga matjet e fundit ishin 45% që është shumë më mirë se Kosova në matjen e fundit. Krahasuar me Këshillin Gjyqësor, Gjykatat e Kosovës radhiten në vendin e tretë në rajon me një rezultat prej 43% të treguesve, pas Malit të Zi i cili i prinë rajonit me 56% të treguesve dhe Shqipëria me 45% të treguesve. Kosova e lë pas Serbinë dhe Maqedoninë të cilat kanë shënuar 39% dhe vendi i fundit është Bosnja dhe Hercegovina që ka shënuar me 25% në nivelin e transparencës. Kosova duke u renditur e pesta në matjen e fundit, është ngjitur dhe radhitet e treta në matjen e këtij viti. Kjo pasi që gjykatat kanë punuar drejt publikimit të punës së tyre dhe kanë përditësuar prezencën e tyre online. Përderisa shkalla në të cilën Kosova mbetet pas vendeve tjera të Ballkanit është e rëndësishme, një vështrim më i afërt tregon se disa fusha janë veçanërisht të lëna pas dore, ndërsa të tjerat qëndrojnë relativisht mirë.

#### Qasshmëria

Qasja si mjet i transparencës matet përmes qasjes në informata, qasje në procedurat gjyqësore dhe publike. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është deri tani Këshilli Gjyqësor më së paku i qasshëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor, i cili e ka lënë pas vetëm Shqipërinë. Përderisa Mali i Zi radhitet i pari me një rezultat prej 79%, Kosova ka arritur të ngritet prej vetëm 18% krahasuar me matjen e fundit ku shënoi 28%. Ky rezultat mediokër u atributohet një numri faktorësh. Së pari, Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka një mekanizëm për komunikim me media, të cilët nuk lejohen të ndjekin seancat e KGJK-së (përveç rasteve me përjashtim). Kjo përkundër faktit se Këshilli ka themeluar një Zyrë të dedikuar për Informata Publike.

Së dyti, KGJK nuk ka një mekanizëm publik të ankesave i cili do t'u mundësonte qytetarëve të ngrisin ankesa lidhur me punën e gjyqtarëve dhe shërbyesve civil. Së treti, mungon një sistem trajnues dhe udhëzues i cili do t'i pajiste punonjësit e gjykatës me aftësitë për të vlerësuar informatat për publikim duke përbushur kështu obligimet sipas ligjit të së Drejtës Për Informim.

### Efikasiteti


Ndërgjegjësimi është një fushë tjetër në të cilën Këshilli Gjyqësor i Kosovës e gjen veten në fund të renditjes rajonale sikurse në matjen e fundit. Ndërsa këshillat gjyqësorë të Bosnjës dhe Malit të Zi përbushin 100% të kriterëve, KGJK-ja shënon vetëm 34% që është një rënie në pikë krahasuar me matjen ku Kosova shënoi 47%. Krahasuar me KGJK-në, gjykatat e Kosovës janë përmirësuar në pozitë dhe kanë rritur rezultatin e tyre nga matja e fundit ku, nga 31% e treguesve të caktuar nga matja e fundit, këtë vit kanë 58%, duke u renditur kështu në vendin e tretë në rajon. Të dhënat e mbledhura tregojnë, pra, se gjykata e Kosovës ka punuar në ndërgjegjësimin që përfshin monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe performancën e tyre.

### Integriteti

Disponueshmëria e informatave, udhëzimeve dhe procedurave lidhur me integritetin e sistemit gjyqësor në matjen e fundit ishte pika më e fortë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës duke shënuar 82% të treguesve të përcaktuar. Ndërkaq, këtë vit KGJK-ja ka rënë duke shënuar 61% të treguesve të përcaktuar. Duke lënë pas Maqedoninë me 57% të treguesve të përcaktuar dhe Shqipërinë me 1%. Megjithatë, duhet të përmendet se përbushja e kriterit që është vlerësuar këtu ka të bëjë vetëm me ekzistimin e Kodit Etik për gjykatës dhe personelin e gjykatave. Ata nuk e përfaqësojnë në asnjë mënyrë nivelin e vërtetë të integritetit të sistemit gjyqësor të Kosovës. Sistemi gjyqësor në Kosovë nuk i përbush disa prej kriterëve, më saktësisht ekzistimin e procedurave për paraqitjen e ankesave kundër sjelljes së dyshuar joetike, studime për të vlerësuar besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe nevojën për trajnim obligativ të etikës për gjykatësit.

## Transparenca

Tri nënkategori janë hulumtuar brenda kategorisë së “Transparencës” – transparenca e informimit buxhetor, informatave organizative dhe e prokurimit publik. Transparenca e përgjithshme e informatave të ofruara nga KGJK-ja është e ulët. Prokurimi publik dhe transparenca buxhetore janë pengesat kryesore për përmirësimin e performancës së KGJK-së në përgjithësi dhe do të duhej të përbënin një nga fushat me përparësi për ndërhyrje për vendimmarrësit. Veçanërisht, përpjekjet për përmirësimin e performancës do të duhej të fokusoheshin në sigurimin se planet, thirrjet, vendimet dhe kontratat e prokurimit publikohen në uebsajtin e Gjykatës, si dhe buxhetet dhe llogaritë përfundimtare të shpenzimeve buxhetore. Përderisa KGJK-ja ka shumë probleme lidhur me transparencën, Gjykatat e Kosovës kanë arritur rezultat prej 46% krahasuar me vitin e kaluar kur shënuan 37.5%. Nga viti i tretë në matjen e vitit të kaluar, këtë vit ato radhiten të dytat në transparencë, të kaluara vetëm nga Mali i Zi me 52% të treguesve të caktuar për gjykata. Brenda sistemit institucional të Kosovës, transparenca e gjykatave qëndron shumë afër me nivelin e përgjithshëm të transparencës së vëzhguar nëpër të gjitha institucionet e hulumtuara.



### 2.3.2 HAPAT E VEPRIMIT


Në mënyrë që të rrisë rezultatin e tij të përgjithshëm, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të ndërmarrë hapat në vijim:

- Të zhvillohen udhëzime të dedikuara për shtyp që përcaktojnë rregullat dhe parimet që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet Këshillit dhe mediave dhe u mundësojnë përfaqësuesve të medias të marrin pjesë në seancat e Këshillit, me përjashtime të nevojshme
- Të krijohet një praktikë e kryerjes së anketave për besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor
- Të krijohet një trajnim dhe një sistem i udhëzimit për t'i mundësuar punonjësve të gjykatave që të vlerësojnë të dhënat, grupet e të dhënave dhe informacione të tjera
- Të sigurohet shqyrtimi i të gjitha raporteve të zbatimit të paraqitura nga gjykatat dhe të përcaktohen qartë obligimet dhe afatet për raportim nga gjykatat
- Të alokohen linjat e ndara buxhetore të buxhetit të Këshillit për mirëmbajtjen, operimin dhe kostot e ndërtimit, investimet në ndërtesat e reja, ndihmën juridike, trajnimin dhe edukimin e gjyqtarëve dhe kompjuterizimin (pajisjet, investimet dhe mirëmbajtjen)
- Të krijohet një procedurë për paraqitjen e ankesave ndaj sjelljeve jo-etike në lidhje me punën e gjyqtarëve dhe nëpunësve civil dhe të krijohet qasja në informata përkatëse në ueb faqen e Këshillit
- Të sigurohet që planet, thirrjet, vendimet, kontratat dhe anekset lidhur me prokurimin publik janë të publikuara në ueb faqen e Këshillit
- Të publikohen programet e punës, planet dhe informacionet lidhur me personelin (duke përfshirë emrat dhe pozitat), pagat, kontaktet me anëtarët e Këshillit, fushëveprimet institucionale, organogrami dhe rezymetë e stafit, si dhe listat e regjistrave të dokumenteve në posedim të tij në ueb faqen e tij.
- Këshilli duhet të sigurojë që ueb faqja të përditësohet rregullisht dhe vazhdimisht me informacione aktuale.

### 2.3.3 HAPAT E VEPRIMIT të Gjykatave

Në mënyrë që të rrisë rezultatin e saj të përgjithshëm, Gjykatat e Kosovës duhet të ndërmarrë hapat në vijim:

- Të sigurohet që procedurat gjyqësore të jenë të hapura për publikun, me përjashtime specifike, të përcaktuara mirë dhe të justifikuara
- Të sigurohet që vendimet të përfshijnë arsyetimin e vendimit
- Të publikohet organogrami institucional, fushëveprimi i punës, emrat, pozitat, pagat dhe rezymetë e stafit, strategjitë aktuale të gjyqësorit, programet dhe planet e punës, listat e regjistrave të dokumenteve në posedim të Gjykatës, të dhënat nga dëgjimet (me përjashtime të kufizuara) statistikave mbi vëllimin e rasteve të pranuar, normat e miratimeve, kohëzgjatja e lëndëve të pazgjidhura (nga gjykata dhe gjykatësi), anonimiteti i aktgjyqimeve në rastet kundër të miturve në ueb faqen e Gjykatës.
- Përditësimi i vazhdueshëm i ueb faqes me këto dhe informata të tjera të kërkuara ligjërisht.
- Të lëshohet një ndalesë e përgjithshme ndaj pjesëmarrjes së publikut në rastet kundër të miturve
- Të vendosen masat mbrojtëse ndaj vonesës (standardet e performancës, koha normale për fazat në procedurat gjyqësore)
- Të forcohet më tej detyrimi për të dërguar një raport tek autoriteti kompetent
- Të mundësohet që qytetarët të ndjekin zhvillimin e rastit të tyre në internet
- Të institucionalizohet një procedurë lidhur me përdorimin e gjuhëve të pakicave
- Të krijohet një mekanizëm publik i ankesave në lidhje me punën e gjyqtarëve dhe nëpunësve civilë
- Të krijohet një trajnim dhe një sistemi të udhëzimit për t'i mundësuar punonjësve të gjykatave që të vlerësojnë të dhënat, grupet e të dhënave dhe informatave të tjera që duhet zbuluar dhe të ndërmarrin detyrimet e tyre në përputhje me ligjin mbi të Drejtën për Informim.





## 2.4 KËSHILLI PROKURORIAL

### 2.4.1 REKOMANDIMET

Këshilli Prokurorial i Kosovës njëjtë si në matjen e vitit të kaluar shtrihet drejt mesit rajonal sa i përket performancës së tij. Ai i përmbush 48% të treguesve të matur. Pasohet nga Maqedonia me 20% dhe Shqipëria me 0% të treguesve, por mbetet prapa këshillave në Serbi me 51%, Bosnjë me 62% dhe Mal të Zi me 62%. Nga një pikëpamje kombëtare, Këshilli Prokurorial është po aq i suksesshëm sa institucionet tjera prokuroriale si Prokuroria Publike dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

#### Qasshmëria

Krahasuar me matjet e vitit të kaluar ku qasja në informata ishte thembra e Akilit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, duke përmbushur vetëm 18.2% këtë vit, kjo matje ka shënuar 42% të treguesve të përcaktuar duke u radhitur në vendin e tretë në rajon. Rezultati i ulët i KP-së është si rrjedhojë e dështimit për të vënë në dispozicion informatat e kontaktit të personit përgjegjës për Lirinë e Informimit, për të krijuar një mekanizëm publik të ankesave lidhur me punën e prokurorisë dhe mungesën e udhëzimeve që rregullojnë raportimin e mediave dhe që u mundësojnë punonjësve të prokurorisë të vlerësojnë informatat dhe të ndërmarrin detyrimet e tyre sipas ligjit të së Drejtës për Informim. Standardi i vetëm i plotësuar është publikimi i vendimeve të Këshillit Prokurorial në faqen e vet të internetit.

#### Ndërgjegjësimi

Ndërkohë që Këshilli Prokurorial i Kosovës qëndron më mirë në vetëdijësim në përgjithësi, ai është relativisht më keq në krahasim me vendet fqinje. Ai zë vendin e dytë në vendin prej fundit me 50%, me Shqipërinë që zë vendin e fundit me 0% dhe Bosnja dhe Hercegovina duke shënuar 100% të plotë. Këshilli Prokurorial i Kosovës shënon 100% në nënkategorinë e monitorimit të punës por nuk arrin të monitorojë veten me vetëm 39% të treguesve të caktuar. Mangësitë janë gjetur kryesisht në raportimin ku nuk ka obligim dhe afat për raportimin e Prokurorisë pranë autoritetit kompetent, ka mungesë të rregulloreve që specifikojnë përmbajtjen dhe format e raporteve të KP-ve dhe Zyra e Prokurorisë nuk i raporton problemet që ndodhin në raportin e punës. Kriteret e vetme të plotësuara janë kërkesa e KP-së për të dorëzuar një raport mbi punën e tij dhe për ato raporte të përfshijë masa disiplinore për prokurorët.

## Integriteti

Këshilli Prokurorial performon dukshëm më mirë në integritet sesa në dy variabël e mëparshme. Por, duke marrë parasysh matjet e vitit të kaluar ku shënoi 80% të treguesve dhe zë pozitën e tretë rajonale, këtë vit shënoi 59% të treguesve, duke u renditur i katërti duke lënë prapa Maqedoninë dhe Shqipërinë. Në krye të rajonit është Mali i Zi me 80%, pasuar nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Këshill Prokurorial në Kosovë ka rezultatin më të lartë duke pasur kodin e etikës (75%) dhe Pavarësinë në punë (62%) nuk arrin të bëjë asnjë lloj dokumenti që pengon konfliktin e interesit, ndërsa Kosova ka shënuar 0%. Dy standardet që e ulin rezultatin e integritetit të KP-së janë mungesa e sondazheve që vlerësojnë besimin e qytetarëve në prokurori dhe mungesa e një sistemi disiplinor formal në lidhje me ankesat kundër prokurorëve.

## Transparenca

Rezultati i Këshillit Prokurorial të Kosovës për transparencë është nën nivelin mesatar, me 44% të treguesve të caktuar, ndërsa vitin e kaluar kishte 34% të kriterëve të përmbushura Shqyrtimi i rezultateve më thellë nën sipërfaqe nxjerr në pah dallimet e mëdha midis transparencës buxhetore, informatave organizative dhe prokurimit publik. Përderisa Këshilli Prokurorial i Kosovës krenohet me vendin e parë në transparencën e informatave organizative me 78% të treguesve, ai dështon krejtësisht në transparencën buxhetore dhe prokurimin publik, ku ka shënuar 0%. Sa i përket transparencës buxhetore, Këshilli Prokurorial nuk i vë në dispozicion buxhetet në internet dhe llogaritë përfundimtare të shpenzimeve buxhetore nuk janë të publikuara në faqen e internetit.

## 2.4.2 HAPAT E VEPRIMIT

Në mënyrë që të rritet hapja e tij, Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të ndër marrë hapat në vijim:

- Të përpilohen udhëzime që rregullojnë raportimin e medias në bazë të rishikimit të Këshillit
- Të publikohen informatat kontaktuese të personit përgjegjës për Lirinë e Informacionit në zyrën e prokurorisë
- Të krijohet një trajnim dhe sistem të udhëzimit për t'i mundësuar punonjësve të prokurorisë të vlerësojnë të dhënat, grupet e të dhënave dhe informacionet e tjera
- Të përcaktohen obligimet dhe afatet e raportimit nga ana e Prokurorive pranë autoriteteve kompetente dhe të përcaktohen rregullat që përcaktojnë formën dhe përmbajtjen e këtyre raporteve
- Të detyrohet Këshilli që të dorëzojë raporte për punën e tij
- Të alokohen linja të ndara buxhetore të buxhetit të Këshillit për mirëmbajtjen e ndërtesës, operimin dhe harxhimet, infrastrukturën teknike, ndihmën juridike, trajnimin dhe edukimin e prokurorëve
- Të krijohet një praktikë e kryerjes së sondazheve për besimin e qytetarëve në zyrën e prokurorit
- Të krijohet një mekanizëm publik i ankesave dhe një sistem disiplinor formal për ankesa kundër prokurorëve dhe punën e tyre
- Të sigurohet që planet, thirrjet, vendimet, kontratat dhe anekset lidhur me prokurimin publik janë të publikuara në ueb faqen e tij
- Të publikohen programet e punës, planet, listat e regjistrave të dokumenteve në posedim, informacionet lidhur me personelin (duke përfshirë emrat dhe pozitat), pagat, kontaktet me anëtarët e Këshillit
-

## 2.5 ZYRA E KRYEPROKURORIT

### 2.5.1 REKOMANDIMET

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit mbetet prapa pothuajse prej të gjitha institucioneve të tilla në rajon, duke u radhitur kështu e fundit në rajon për transparencë duke shënuar vetëm 30% të treguesve të caktuar. Ky është rezultat shqetësues pasi që Zyra e Kryeprokurorit nuk ka punuar drejt transparencës nga matja e kaluar ku ishte radhitur e dyta prej fundit, edhe pse është përmirësim në rezultat prapëseprapë nuk ka mundur të arrijë hapin me shtetet e tjera.

#### Qasshmëria

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës radhitet e fundit në rajon duke shënuar vetëm 10% të treguesve të përcaktuar në krahasim me matjen e vitit të kaluar ku ky rezultat ishte 27.3%. Të gjitha shtetet tjera kanë shënuar mbi 50% të treguesve të përcaktuar në këtë pikë. Arsyet kryesore për këtë janë mungesa e monitorimit të mediave lidhur me punën e prokurorisë, qasja në informata, dështimi për të publikuar listat e regjistrave të dokumentave që i posedon, mungesa e qasjes në objektet e prokurorisë për publikun dhe mungesa e një procedure për përdorimin e gjuhëve të minoriteteve.

#### Ndërgjegjësimi

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit i përmbush pothuajse vetëm gjysmën e standardeve të vlerësuara sa i përket vetëdijësimit, gjë që e radhitë atë në vendin e parë me Malin e Zi, të dyja vendet duke shënuar 52% të treguesve, për të vazhduar me Maqedoninë e cila ka shënuar 47% dhe shtetet e tjera kanë shënuar 0% në këtë nivel. Kjo është kryesisht sepse zyra e kryeprokurorit të shtetit monitoron në njëfarë niveli punën në zyrë, përfshirjen e masave disiplinore dhe ankesat kundër prokurorëve në raportin vjetor dhe ekzistimin e një mekanizmi mbikëqyrës. Mungesat që duhet të plotësohen janë: duke përfshirë treguesit e performancës, p.sh. krijimi i një mekanizmi për ndarjen e rasteve dhe sigurimin e mbikëqyrjes së Zyrës nga një autoritet kompetent.

## Integriteti

Në krahasim me matjen e vitit të kaluar kur Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në Kosovë i përmbushi të gjitha kriteret brenda kategorisë së integritetit dhe zuri vendin e parë në krahasimin rajonal, në matjet e këtij viti ajo radhitet e fundit me 10% të treguesve. Përderisa të gjitha shtetet tjera kanë shënuar mbi 50%, ky rezultat i ulët i arritur nga Kosova është brengosës. Megjithatë, është përsëri e rëndësishme të përmendet se kriteret të cilat e masin integritetin me kodin etik, konfliktin e interesit dhe monitorimin e punës kanë të bëjnë me publikimin e tyre për përdorim nga palët e interesuara. Duhet të ceket se elementi i integritetit nuk e pasqyron gjendjen e vërtetë sa i përket integritetit brenda Zyrës.

## Transparenca

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dallohet për arritjen e saj për transparencë, ajo i plotëson kriteret për 39% të treguesve duke u radhitur kështu e dyta në rajon pas Malit të Zi i cili ka shënuar 56% të treguesve të përcaktuar. Për të arritur rezultate më të mira në këtë drejtim Zyra e Kryeprokurorit duhet të jetë më e hapur dhe transparente në çështjet buxhetore dhe të prokurimit publik, për dyjat prej të cilave Zyra ka marrë përqindje prej 0%. Gjendja është më optimiste vetëm sa i përket informatave organizative, duke shënuar 61% të treguesve të përcaktuar. Buxheti dhe llogaritë përfundimtare të shpenzimeve buxhetore nuk publikohen në uebsajt e as planet, thirrjet, vendimet, kontratat dhe shtojcat e prokurimit. Transparenca e informatave organizative do të mund të rritej më shumë duke u përqendruar në publikimin e organogramit të plotë, punëve, rezymeve, programeve dhe planeve të punës dhe informatave të personelit si dhe duke i vënë në dispozicion të gjitha të dhënat në një tabelë njoftimi siç është e paraparë me ligj.

## 2.5.2 HAPAT E VEPRIMIT

Për të rritur rezultatin e përgjithshëm, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit duhet të ndërmarrë hapat në vijim:

- Të krijohet një tabelë njoftimi në prokurori dhe të publikohen në të të gjitha informatat e kërkuara ligjërisht
- Të sigurohet qasja e lirë e publikut në zyrat e prokurorisë
- Të krijohet një praktikë e raportimit mbi monitorimin e rezultateve të medias në lidhje me punën e prokurorisë
- Të krijohet një procedurë lidhur me përdorimin e gjuhëve të pakicave
- Të krijohet një mekanizëm për ndarjen sistematike të rasteve
- Të sigurohet që raporti për punën e ndërmarrë në vitin paraprak dërgohet tek autoriteti kompetent dhe se raporti përfshinë tregues të performancës për veprimtarinë e Zyrës (numri i rasteve të zgjidhura, numri i vendimeve të dorëzuara etj.),
- Të mbikëqyret rregullisht puna e Prokurorisë Themelore të Shtetit - të përcaktohen proceset e kërkuara dhe kapacitet e personelit të akorduar.
- Të sigurohet që informacioni i kuptueshëm dhe gjithëpërfshirës për buxhetet dhe llogaritë përfundimtare mbi shpenzimet buxhetore të publikohen në ueb faqen e Zyrës (duke përfshirë tabelat dhe sqarimet verbale)
- Të sigurohet që planet, thirrjet, vendimet, kontratat dhe anekset në lidhje me prokurimin publik janë të publikuara në ueb faqen e Zyrës
- Të publikohet organogrami institucional, fusha e veprimit, rezymetë e stafit, programet dhe planet e punës, lista e regjistrave të dokumenteve në posedim të saj në ueb faqen e Zyrës, si dhe informacione të tjera ligjore.
- Të krijohet një trajnim dhe sistem të udhëzimit për t'i mundësuar punonjësve të prokurorisë të vlerësojnë të dhënat, grupet e të dhënave dhe informacione të tjera dhe të ndërmarrin detyrimet e tyre në përputhje me Lirinë e Informimit.

## 2.6 KOMUNAT

### 2.6.1 REKOMANDIMET

Vetqeverisja lokale është një element thelbësor në afrimin e përfaqësuesve politikë me zonat e tyre zgjedhore dhe krijimin e lidhjeve të forta mes qytetarëve dhe institucioneve publike. Kjo lidhje bën të mundur që zyrtarët të kuptojnë problemet dhe shqetësimet e komuniteteve lokale, të krijojnë zgjidhje të politikave që maksimizojnë mirëqenien sociale dhe ofrojnë shërbime që u përgjigjen nevojave të qytetarëve. Funksionimi i qeverive lokale është një tregues i mirë i angazhimit të përfaqësuesve politikë për t'i shërbyer interesit publik. Në krahasimin rajonal të vetqeverisjeve lokale, Kosova renditet e fundit në regjion duke shënuar vetem 23% të treguesve të caktuar, duke e krahasuar me matjet e fundit, ku Kosova ishte renditur e fundit me 26% të kriterëve të përmbushura, kjo tregon që ka një rënie të lehtë. Në përgjithësi të gjitha vendet e Ballkanit perëndimor kanë shënuar në mes 23-28% të treguesve të vendosur në nivel lokal, duke veçuar Malin e Zi që ka shënuar 48%.

## 2.6.2 HAPAT E VEPRIMIT

- Komunat duhet të publikojnë planet për prokurimet publike, vendimet, kontratat, shtojcat për kontratat si dhe shpenzimet tjera komunale.
- Komunat duhet të sigurojnë më shumë informata në faqet e tyre duke filluar nga struktura organizative deri tek procedurat e prokurimit.
- Komunat duhet të fokusohen në forcimin e ndërveprimit me qytetarët, pasi ato janë dera e parë e bashkëpunimit me institucionet publike.
- Përmirësimin e komunikimit me qytetarët përmes rrjeteve sociale, publikimi i buletineve mujore për qytetarët për punën e komunave.
- Komunat duhet të miratojnë planet kombëtare mbi integritetin ose ndonjë politikë tjetër të brendshme në luftën kundër korrupsionit.
- ka mungesë të njoftimeve për organizimin e debateve publike për qytetarët për çështje me interes lokal,
- Faqet e internetit të komunave duhet të përfshijnë informacion mbi strukturën organizative, buxhetin operacional dhe informacionin mbi prokurimet publike, planet e prokurimit publik për vitin aktual në veçanti, vendimet, kontratat dhe anekset e saj të lidhura në prokurimet publike të hapura si dhe shpenzimet tjera komunale.
- Përveç kësaj, buxhetet e miratuara dhe llogaritë përfundimtare duhet të publikohen në formate të hapura, të cilat e bëjnë më të lehtë kërkimin.
- Komunat duhet të publikojnë planet e prokurimit publik, vendimet, kontratat dhe anekset për kontratat, si dhe shpenzimet e tjera komunale.
- Strategjitë zhvillimore me synime të përcaktuara qartë zhvillimore,
- Strategjia uniforme e transparencës në mes të komunave
- Promovoni një thirrje për pjesëmarrje qytetare në konsultimet publike për krijimin e buxhetit në faqet e tyre





### 3. METODOLOGJIA

“Indeksi Rajonal i Hapjes” është një tregues i përbërë që mat shkallën në të cilën qeveritë në vendet e Ballkanit Perëndimor janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë. Hapja është një kusht kyç për demokracinë, sepse u mundëson qytetarëve që të marrin informacionin dhe njohuritë që kanë nevojë për të marrë pjesë si të barabartë në debatet publike, për të marrë vendime të zgjuara dhe për të mbajtur qeveritë përgjegjëse. Hapja gjithashtu mbështet qeverisjen e mirë sepse lejon elitat qeverisëse të marrin në konsideratë dhe të tërheqin idetë dhe ekspertizën e shpërndarë në shoqëri. Qeveria e hapur bazohet në katër parime organizative: transparencë, qasje, integritet dhe ndërgjegjësim. Këto parime zbatohen për të gjitha degët dhe nivelet e qeverisjes, nga ekzekutivi qendror në vetëqeverisjen lokale, kuvendin dhe sistemin gjyqësor.

Parimi i transparencës do të thotë që një qeveri jep informacione të qarta dhe relevante publike për atë se çfarë bën. Këto informacione kanë të bëjnë me organizimin dhe punën e institucioneve qeveritare dhe në veçanti për buxhetin dhe procedurat e prokurimit publik.

Transparenca u mundëson qytetarëve dhe publikut të kuptojnë dhe vlerësojnë punën e qeverisë. Sidoqoftë, transparenca e qeverisë mund të kufizohet nga pengesat që pengojnë qytetarët dhe publikun nga qasja në informacionin që ata e perceptojnë si të rëndësishme. Një qeveri e hapur duhet gjithashtu të kërkojë të heqë pengesat e tilla dhe të akomodojë shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve dhe shoqërisë. Prandaj, hapja kërkon që autoritetet publike të përpiqen të sigurojnë të gjitha mundësitë dhe procedurat për qasje dhe për të rritur qasjen e tyre.

Ndërgjegjësimi nënkupton disponueshmërinë dhe sigurimin e informacionit dhe njohurive brenda qeverisë. Ky parim është veçanërisht i rëndësishëm për ekzekutivin pasi kjo degë e qeverisë është besuar me ushtrimin e pushtetit shtetëror. Për këtë arsye kushtetutat liberale i kanë caktuar kompetencat degëve legislative dhe gjyqësore që u lejojnë atyre të monitorojnë dhe shqyrtojnë politikën dhe veprimet e ekzekutivit. Sa i përket kuvendit dhe gjykatave, ndërgjegjësimi konsiderohet kështu si kapaciteti i këtyre institucioneve për të monitoruar punën e ekzekutivit. Por ndërgjegjësimi gjithashtu i referohet disponueshmërisë së njohurive brenda ekzekutivit qendror, kjo do të thotë shkëmbimi i informacionit ndërmjet ministrive të ndryshme dhe rregullimi i institucioneve që përbëjnë ekzekutivin qendror - kabinetin, sekretariatit e përgjithshëm ose zyrën e kryeministrit, kryeministrin dhe institucionet e tjera koordinuese, p.sh. njësitë e hartimit të legjislacionit.

Ndërsa transparenca ndaj publikut, qasja, integriteti dhe ndërgjegjësimi organizativ nxisin llogaridhënien, ato nuk mbulojnë plotësisht llogaridhënien, pasi përgjegjësia përfshin gjithashtu mundësinë e qytetarëve apo përfaqësuesve të tyre sanksionimin e qeverisë të cilën ata e konsiderojnë si shkelëse të përgjegjësive të saj. Indeksi i Hapjes nuk përfshin këtë dimension të llogaridhënies; është i përqendruar në kushtet informative dhe njohëse të përgjegjësisë të kuptimit demokratike.

Katër parimet ndahen më tej në pyetje individuale që vlerësohen në bazë të ueb faqeve, burimeve të tjera të informacionit publik dhe intervistave. Indeksi i Hapjes vlerëson se si këto katër parime realizohen në institucione ose grupet e institucioneve të mëposhtme: ekzekutivi qendror; ministritë përkatëse; agjencitë ekzekutive; kuvendi; vetëqeverisja lokale; gjykatat; prokuroria publike. Meqenëse këto institucione kryejnë funksione të ndryshme në procesin e qeverisjes ose të krijimit të politikave, pyetjet individuale përshtaten për të përputhur profilet e institucioneve përkatëse.

## 4. PROJEKTI

Qeverisja e mirë është çelësi i sundimit të ligjit. Dhe gjersa çështjet e korrupsionit, transparencës, sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë janë gjithnjë në qendër të vëmendjes, mbetet mungesa e të kuptuarit dhe problemeve sistematike që mezi mbulojnë mjaftueshëm. Projekti “Llogaridhënia, Teknologjia dhe Transparenca Institucionale në Evropën Juglindore - ACTION SEE” synon të rrisë ndërgjegjësimin për këto sfida duke lehtësuar bashkëpunimin midis organizatave civile dhe përpjekjet strategjike të konsoliduara për përfaqësim.

ACTION SEE siguron një platformë për dialog dhe një mjet konkret për matjen e shkallës në të cilën institucionet shtetërore respektojnë parimet dhe standardet e qeverisjes së hapur (Indeksi i Hapjes).

Projekti synon të rrisë përfshirjen e shoqërisë civile dhe të organizatave mediatike në proceset vendimmarrëse dhe krijimin e opinionit publik dhe politikave, si dhe rritjen e kapacitetit të shoqërive qytetare për të trajtuar çështje të ndjeshme.

### Objektivat specifike të projektit

- ☞ Promovimi i një shoqërie civile dinamike e cila në mënyrë efektive mobilizon qytetarët për pjesëmarrje aktive në çështjet lidhur me sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë dhe ndikon politikën dhe proceset e vendimmarrjes në nivel kombëtar dhe rajonal.
- ☞ Forcimi i mekanizmave për dialog midis organizatave qytetare dhe institucioneve qeveritare dhe ndikimi i qeverisjes së mirë dhe reformave të administratës publike.
- ☞ Nxitja e rrjetëzimit të organizatave qytetare dhe të medias në nivel lokal dhe në nivel BE-së, duke lejuar shkëmbimin e njohurive, shkathësive dhe lidhjeve, si dhe rritjen e ndikimit të përpjekjeve të tyre të përfaqësimit.

